

Keni pyetje?

Mos hezitoni t'u bëni profesionistëve që kujdesen për ju ose foshnjën çfarëdo pyetjeje që mund të keni në lidhje me këtë depistim. **Mund dhe të ndiqni këtë lidhje: depistage-neonatal.fr**

Për informacion të mëtejshëm mbi sëmundjet e depistuara, **skanoni këtë kod QR.**



QENDRA JU AJ RAJONALE

Informacion për të dhënat tuaja personale

Depistimi neonatal përfshin mbledhjen e të dhënave në lidhje me shëndetin e fëmijës dhe informacionin personal rreth jush, të cilat do të na mundësojnë të kontaktojmë me ju nëse është e nevojshme.

Këto të dhëna transmetohen në mënyrë të sigurt në qendrën rajonale të depistimit neonatal, e cila është përgjegjëse për përpunimin e tyre.

Mund të gjeni informacion në lidhje me këtë trajtim dhe të drejtat tuaja në fletëpalosjen e disponueshme në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare për Depistimin Neonatal (CNCND): depistage-neonatal.fr

Hapat e depistimit pas lindjes së foshnjës



Jeni duke pritur një fëmijë ose fëmija sapo ka lindur.

Depistimi që nga lindja është i rëndësishëm

Në Francë, të gjithë neonatët i nënshtrohen një kontrolli falas 2-3 ditë pas lindjes për të zbuluar disa sëmundje serioze. Kjo fletëpalosje ofron informacion në lidhje me objektivat dhe procedurën e këtij depistimi.



PALËT E INTERESUARA



Dokumente të hartuara në bazë të punës së Autoritetit të Lartë Shëndetësor dhe Ministrisë së Shëndetësisë

Korrik 2025

Çfarë është depistimi që në lindje?

Te foshnjat, disa sëmundje nuk janë të dukshme në ditët që pasojnë lindjen. Por ato mund të **zbulohen** me anë të një analize gjaku.

Pse duhet depistuar të gjitha foshnjat?

Ky depistim u ofrohet të gjitha foshnjave, edhe nëse janë mirë. Ndihmon në **zbulimin e disa sëmundjeve të rralla sa më herët të jetë e mundur** dhe në fillimin e trajtimit edhe para se të shfaqen shenjat e sëmundjes. Qëllimi është të parandalohet që foshnja të vuajë nga pasoja të përhershme dhe t'i mundësohet të zhvillohet dhe të rritet sa më mirë të jetë e mundur.

Si funksionon depistimi?

Në thelb, një mami, infermiere pediatrike ose infermiere e zakonshme shpon thembrën ose shpinën e dorës së foshnjës dhe merr disa pika gjaku, të cilat vendosen në një letër thithëse. Kjo analizë është **e shpejtë dhe e sigurt**.

“Për ta qetësuar foshnjën dhe për t'i lehtësuar dhimbjen nga shpimi, mbajeni në krah ose lëreni të thithë.”



Në repartin e maternitetit ose në shtëpi.



2-3 ditë pas lindjes.

Letra thithëse dërgohet më pas në një laborator për analizë.

Për cilat sëmundje bëhet depistimi?

Sëmundjet për të cilat bëhet depistimi janë të rralla, por ato janë serioze, shpesh me origjinë gjenetike dhe zgjasin gjithë jetën.

...o Çrregullime të caktuara hormonale

parandalojnë funksionimin e duhur të hormoneve dhe çojnë në pasoja të konsiderueshme (paaftësi intelektuale, vonesë në zhvillim etj.).

...o Çrregullime të caktuara metabolike

e pengojnë trupin të shfrytëzojë siç duhet ushqimin dhe mund të çojnë në pasoja të rënda (paaftësi intelektuale, vonesë në zhvillim etj.).

...o Fibroza cistike

shkakton infeksione të shpeshta të mushkërive dhe vështirësi në frymëmarrje, si dhe vështirësi në tretje.

...o Sëmundja e qelizave drapër

shkakton anemi (mungesë të rruazave të kuqe), dhimbje dhe infeksione.

...o Deficiencë e rëndë e kombinuar e imunitetit

shkakton infeksione të rënda respiratore.

...o Atrofi muskulore spinale infantile

gradualisht shkakton dobësi të rëndë në të gjithë muskujt, së bashku me probleme respiratore.

Për informacion të mëtejshëm, **skanoni kodin QR** në kopertinë.

Çfarë ndodh nëse foshnja rezulton e prekur?

Do të ofrohet monitorim mjekësor nga një ekip specialistësh, me disa lloje trajtimesh në dispozicion:

...o produkte mjekësore

...o dietë e përshtatur ndaj sëmundjes

Këto trajtime do t'i mundësojnë foshnjës të zhvillohet sa më mirë të jetë e mundur.



Si prindër, kërkohe pëlqimi juaj

Ky depistim është thelbësor për fëmijën. Do të kryhet vetëm me pëlqimin tuaj. Do t'ju kërkohe të jepni pëlqimin me shkrim për analizën gjenetike që është i nevojshëm për të kontrolluar sëmundje të caktuara.

Nëse keni ndonjë pyetje, mund t'i diskutoni me një profesionist të kujdesit shëndetësor.

“Refuzimi i depistimit ose analizës gjenetike duhet të shprehet me shkrim dhe të nënshkruhet.”



Si do të informoheni për rezultatet?

Në shumicën e rasteve, rezultatet janë normale dhe prindërit nuk kontaktohen.

Mund të kontaktoheni nga qendra rajonale e referencës pas një ose dy javësh në dy raste:

- ...o ose për përsëritjen e depistimit sepse letra thithëse ishte e papërdorshme;
- ...o ose sepse rezultatet duhet të kontrollohen. Mjekët duhet ta vizitojnë sërish foshnjën për të sugjeruar analiza të mëtejshme dhe për t'u siguruar që nuk është e sëmurë.

“Nëse nuk keni jeni kontaktuar deri pas 4 javësh, kjo do të thotë se rezultatet janë normale.”



Çdo vit, nga gati 700 000 lindje në Francë, 1400 foshnja diagnostikohen me sëmundje të rënda dhe mund të marrin trajtim efikas në një fazë shumë të hershme. Rastet e foshnjave të sëmura që nuk zbulohen nga analizat janë jashtëzakonisht të rralla.